




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.2, datë 30.05.2025



PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIM TË LEJES, NGA
SHOQËRIA "GSA" SH.P.K TEK SHOQËRIA
"GSA FERROKROM" SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 141, të ligjit Nr.29/2024 "Për burimet ujore", vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin e lejes Nr.893, datë 27.12.2024 "Për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale", dhënë me vendim 30 datë 19.12.2024 nga Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin

Nga shoqëria "GSA" sh.p.k me Nipt J61820031J tek shoqëria "GSA FERROKROM" sh.p.k me Nipt M32205014U,

2. Treguesit parapрак janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar për pus-shpimin sipas KRGJSH

- $X = 500552.4$; $Y = 4550080.6$; $Z = 100$ m.m.n.d
- Prurja e kërkuar: $Q = 0.007$ m³/s



3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

ILIR BEJTJA

